



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.1039/17

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Lumni Sallauka e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëses B.Z. nga Gjakova, tani me banim në ... – Republika e Serbisë, të cilin e përfaqësojnë të autorizuarit e saj av.V.A. nga Gjilani dhe V.M., kundër të paditurit M.Z. nga Gjakova, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.P. P. nga Gjakova, për shkak të kthimit në posedim të paluajtshmërisë dhe kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.763/13, të datës 24.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 08.05.2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditëses B.Z. nga Gjakova, tani me banim në ... – Republika e Serbisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.763/13, i datës 24.11.2016, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar Gjakovë C.nr.763/13, të datës 24.11.2016, e ka refuzuar kërkespadinë e paditëses B.Z. nga Gjakova, tani me banim në ... – Republika e Serbisë, me të cilën kishte kërkuar që “të detyrohet i padituri M.Z. nga Gjakova që t’ia kthej në posedim të papenguar banesën e cila gjendet në Gjakovë në rr.”...” numër 7/14, ndërtesa Orize 11 kati IV, në sipërfaqe prej 39.99 m<sup>2</sup>, të liruar në tërësi nga njerzit dhe sendet, si dhe të detyrohet i padituri M.Z. nga Gjakova që në emër të kompensimit të dëmit për shfrytëzimin e paautorizuar të paluajtshmërisë së paditëses, t’ia paguaj shumën prej 2300 euro, në emër të qiras së papaguar në lartësi prej 65 euro, krejt këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Po ashtu është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, paditësja ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të

gabuar jo dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj dhe ta aprovoj kërkesëpadinë e saj si të bazuar, ose që të njëjtin ta prish ashtu që çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditëses, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me datën 14.10.2013, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit për shkak të kthimit në posedim të paluajtshmërisë dhe kompensimit të dëmit, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses, pasi që ka mbajtur seancën kryesore dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.763/13, të datës 24.11.2016, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se prona lëndore evidnetohet në emër të N. Z., përderisa padia është parashtruar nga paditësja B.Z., me çka është vërtetuar se paditëses në rastin konkret i mungon legjitimiteti aktiv në këtë çështje kontestimore, pasi që e njëjta nuk është pronare e banesës dorëzimin e të cilës e ka kërkuar. Me rastin e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 73 të LPK, kurse në raport me shpenzimet procedurale, është vendosur në pajtim ne nenin 452 dhe 453 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kjartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, e të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qendrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në rastin konkret, e në bazë të provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, paditësja me asnjë provë konkrete valide nuk ka arritur ta provoj faktin se asaj i takon e drejta e pronësisë në banesën e cila është objekt i këtij kontesti. Andaj pretendimet e paditëses mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qendrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditëses është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike nga edhe ka rrjedhur pabazueshmëria e kërkesëpadisë së paditëses. Me nenin 37 të LMThJP, parashihet se *“pronari mund të kërkoj me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provoj se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon, e ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet në zotërimin faktik të të paditurit”*. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike nga edhe ka rrjedhur pabazueshmëria e kërkesëpadisë së paditëses. Zbatimi i kësaj dispozite në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditëses në rastin konkret është e pathemeltë, ngase e njëjta me asnjë provë nuk ka arritur ta dëshmojë faktin se është pronare e banesës kontestuese, dorëzimin e të cilës e ka kërkuar. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dhe në kuptim të drejtës materiale të zbatuar në këtë rast, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sikurse në aktgjykimin e ankimuar.

Drejtë është vendosur edhe në lidhje me shpenzimet procedurale dhe atë konform dispozitave të nenit 452 të LPK.

Gjykata e Apelit i analizoi dhe mori për bazë edhe pretendimet e tjera ankimore të paditësit por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.1039/17, me datën 08.05.2020**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari  
Valon Totaj**